



VENDIM

Nr.19 Datë 04.03.2011

PËR

**PRANIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT TË
ERE-S NR.10, DATË 18.02.2011**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.03.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën ankimore të paraqitur nga shoqëria “Albanian Chrome” sh.p.k, për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe rikthimin në statusin e Klientit Tarifor,

Konstatohet se :

Së pari: Pretendimi i parë i shoqërisë “Albanian Chrome” sh.p.k, nuk qëndron, pasi ERE nuk ka miratuar aspak me një procedurë të shpejtuar kërkesën e Shoqërisë “Antea Cement” sh.a për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe marrjen e statusit të klientit tarifor, por ka marrë vendimin e saj brenda 30 ditëve siç parashikohet në Rregulloren për Dhënien dhe Heqjen e Statusit të Klientit të Kualifikuar. Gjithashtu vlen të përmendet fakti se ERE përpara se të merrte vendimin e saj për “Antea Cement” sh.a, ka marrë në konsideratë edhe konfirmimin nga ana e CEZ Shpërndarje sh.a se është i gatshëm të furnizojë pa kosto shtesë shoqërinë “Antea Cement” sh.a nga periudha e kërkuar nga vetë shoqëria “Antea Cement” sh.a. Ndërsa në rastin konkret CEZ Shpërndarje sh.a edhe pse ERE ka pritur deri në ditën e fundit të afatit që përcakton Rregullorja për Dhënien dhe Heqjen e Statusit të Klientit të Kualifikuar, nuk ka depozituar asnjë konfirmim për të furnizuar shoqërinë “Albanian Chrome” sh.p.k nga periudha e kërkuar nga kjo shoqëri.

Së dyti: sa i përket pretendimit të dytë të sipërpërmendur të “Albanian Chrome” sh.a, në interpretim të nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, “Ridëgjimi dhe Ankimi kundër vendimit të Bordit”, vihemi përpara përgjegjësisë për të rishqyrtuar vendimin e ERE-s nr. 10, datë 18.02.2011 “Për mos miratimin kërkesën e shoqërisë “Albanian

Chrome” për marrjen e statusit të Klientit Tarifor sipas kërkeses se tij për kthimin në Klient Tarifor nga data 1 Shkurt 2011, dhe sipas çmimeve të miratuara nga ERE me Vendimin nr. 100, datë 07.12.2010”. Kjo për arsye se shoqëria “Albanian Chrome” sh.p.k në ankesën e paraqitur në ERE parashtron se ka siguruar njëprovë të re (konfirmimin e CEZ Shpërndarje sh.a për ta furnizuar pa kosto shtesë) e cila mund të ndryshojë vendimarrjen e ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të rishqyrtojë vendimin e saj nr. 10, datë 18.02.2011 “Për mos miratimin kërkesën e shoqërisë “Albanian Chrome” për marrjen e statusit të Klientit Tarifor sipas kërkesës se tij për kthimin në Klient Tarifor nga data 1 Shkurt 2011, dhe sipas çmimeve të miratuara nga ERE me Vendimin nr. 100, datë 07.12.2010” për të lejuar palën e interesuar të paraqesë provën e re.
2. Shoqëria “Albanian Chrome” sh.p.k, të paraqesë provën e re deri në datën 7 Mars 2011.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë “Albanian Chrome” sh.p.k për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM

Nr.19 Datë 04.03.2011

PËR

**PRANIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT TË
ERE-S NR.10, DATË 18.02.2011**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____